

Programi i Ekspozitave 2026



Tahir Emra, *Në kolltuk*, 1979. Koleksioni i Galerisë Kombëtare të Kosovës.

Galeria Kombëtare e Kosovës shpall programin për vitin 2026, i cili përfshin dhjetë ekspozita që trajtojnë kontekstin kompleks bashkëkohor përmes çështjeve gjinore, klasore, migrimit dhe ballafaqimit me të kaluarën. Programi i këtij viti do të shtrihet në dy hapësirat e Galerisë Kombëtare të Kosovës (GKK Qendrore dhe Qafa) duke shënuar një fazë të rëndësishme në avancimin e kapaciteteve institucionale. Ky vit shënon një kapitull të ri në historinë e institucionit, jo vetëm në zgjerimin e kapaciteteve fizike, por edhe për përpjekjet e vazhdueshme për të rikonfiguruar dhe sfiduar narrativat marginalizuese dhe patriarkale që kanë shënuar fillimet dhe zhvillimin e tij. Andaj me shumë kënaqësi po e shpalosim një program të dominuar nga artiste gra, me ekspozita personale të para të këtyre artisteve në institucionin e GKK-së.

Pas një viti pune intensive, objekti qendror i GKK-së do të rihapet me hapësira të rinovuara ekspozuese dhe një hapësirë të re të përkushtuar për ruajtjen e koleksionit dhe arkivave. Rihapja shënon një fazë të rëndësishme në zhvillimin institucional duke krijuar kushte të reja dhe të përmirësuara për prezantimin, ruajtjen dhe studimin e trashëgimisë artistike vizuale. Kjo fazë e re inaugurohet me një ekspozitë grupore që vendos në dialog veprat nga koleksioni i GKK-së me



ato të artistëve të rinj bashkëkohorë, duke vënë në pyetje narrativat mbizotëruese të artit në Kosovë dhe rikonceptimin e tyre nga perspektiva e së tashmes. E kuruar nga Hana Halilaj, ekspozita do të sjellë një hapësirë reflektimi kritik mbi vazhdimësitë dhe ndërprerjet në historitë e artit, si dhe mbi rolin e koleksionit si një fushë aktive hulumtimi dhe interpretimi.

Programi në objektin qendror të Galerisë Kombëtare të Kosovës do të vazhdojë më tutje me prezantimin e dy ekspozitave personale të Xhevdet Xhafës dhe Doruntina Kastratit. Ekspozita e Xhevdet Xhafës është duke u zhvilluar që nga viti i kaluar, në bashkëpunim të ngushtë me familjen e artistit. Kjo ekspozitë retrospektive përmbledh opusin e gjerë të punës së frytshme të artistit, e cila artikullohet si dëshmi e realitetit shoqëror dhe politik të vendit, e ndërtuar mbi përvojat e drejtpërdrejta të jetës, rrethit dhe historisë së Kosovës. Pas përfaqësimit tejet të suksesshëm të Pavijonit të Kosovës në Bienalen e Venecias 2025, ku u nderua me mirënjohje të veçantë, GKK prezanton ekspozitën personale të Doruntina Kastratit, të kuruar nga Natasa Petrešin-Bachelez. Ekspozita sjell një përzgjedhje të veprave të saj të mëparshme, të ndërthurura me punë të reja, të komisionuara posaçërisht për këtë rast. Praktika e Kastratit përqendrohet në trupin si hapësirë, duke shqyrtuar tensionin dhe rezistencën brenda biopolitikave të pushtetit, duke artikuluar me ndjeshmëri çështjet shoqërore dhe politike të punës në kontekstin global.

Në program rikthehet *Edicioni i 15-të i Ekspozitës Ndërkombëtare Muslim Mulliqi*, e bashkëkuruar nga May Makki dhe Ana Janevski. Ekspozita do të zhvillohet në formatin e thirrjes së hapur për artistë nga Kosova dhe rajoni, duke prezantuar praktika dhe medime të ndryshme artistike që që i përgjigjen konceptit kuratorial, i cili do të shpallet gjatë vitit.

Në hapësirën GKK-QAFA, do të prezantohen për herë të parë në këtë institucion me ekspozita personale artistet Bora Baboçi, Laureta Hajrullahu, Albe Hamiti, Anita Muçolli dhe Stephanie Rizaj. Po ashtu do të mbahet edhe edicioni i dytë i programit *Shtëpi* në bashkëpunim me *Cité Internationale des Arts*.

Imazhe Migruese nga Bora Baboçi, e kuruar nga Erëmirë Krasniqi, shqyrton qarkullimin, materialitetin dhe virtualitetin e imazheve në trashëgiminë kulturore shqiptare. Përmes muraleve, murit modular dhe strappo-s, veprat krijojnë një hapësirë dinamike dhe ndërvepruese, ku imazhet migrojnë fizikisht dhe konceptualisht. Projekti evidenton marrëdhëniet shoqërore dhe tensionet që përcaktojnë kuptimin dhe funksionin e imazheve brenda historisë dhe kulturës, duke nxitur bashkëbisedim me publikun.

Të Zhbësh, Të Shpërbëhesh, Të Zhdukesh nga Laureta Hajrullahu, kuruar nga Michalina Sablik do të sjellë një instalacion multimedial i cili adreson marrëdhëniet në mes të agjencisë njerëzore dhe sistemeve teknologjike, si dhe ndikimin e kufijve gjeografikë, algoritmikë dhe simboleve mbi ndjenjën tonë të vendit. Hajrullahu evidenton tensionet midis kontrollit dhe autonomisë, duke reflektuar mbi dukshmërinë kulturore dhe negociatat e përditshme brenda sistemeve të standardizuara.



Çfarë mbajmë në vete nga Albe Hamiti, e kuruar nga Sandra Teitge, vazhdon hulumtimin konceptual të projektit *Mother, not an Artist. Artist, not a Mother*. Ekspozita krijon një hapësirë ndërmjet personale dhe kolektive, duke shqyrtuar rolin e gruas dhe mëmësisë në kontekstin shoqëror të Kosovës. Mendimet të grave të cilat mbesin anonime, të integruara në punë, funksionojnë si zëra kolektivë që ndërtojnë një narrativë reflektuese mbi përvojën dhe identitetin gjinor, duke hapur diskutim mbi përfaqësimin dhe kujtesën.

Gjithë të dashurve të tyre nga Stephanie Rizaj shqyrton ndërveprimin midis kushteve të prodhimit, marrëdhënieve të pushtetit dhe përkatësisë shoqërore. Instalacioni përdor etiketat e veshjeve dhe udhëzimet e larjes si bartëse informacioni, të riprodhuara dhe transformuara përmes teknikave analoge dhe dixhitale. Puna evidenton standardizimin dhe anonimizimin e proceseve globale të prodhimit dhe konsumit, duke nxjerrë në pah implikimet estetike dhe politike të prodhimit masiv.

Urat nga Anita Muçolli, kuruar nga Hana Halilaj, fokusohet në përvojat e ndërmjetme dhe në efektet e një gjendje të vazhdueshme pezullimi, duke reflektuar mbi distancën emocionale dhe politike nga ideja e shtëpisë. Praktika e Muçollit shqyrton mënyrat se si traumat kolektive dhe individuale shprehen dhe transmetohen ndër gjenerata. Veprat fokusohen tek narrativat e shpërnguljes dhe sjelljeve që janë në nënvetëdiqe e rikthehen në kohë krize, duke nxjerrë në pah marrëdhëniet e tyre me shtypjen sociale.

Pas suksesit të edicionit të parë, do të vazhdoj bashkëpunimi me *Cité Internationale des Arts* për të mbështetur zhvillimin profesional të artistëve nga Kosova. Përmes thirrjes së hapur, tre artistë me bazë në Kosovë do të përzgjidhen për rezidencën tre mujore në studiot e *Cité Internationale des Arts*, Paris e më pas do të prezantohen në ekspozitën kolektive **Shtëpi II** në GKK Qafa ku do të përkrahen përmes komisionimit të një veprë të re të realizuar me shkas për ekspozitë.

Përveç ekspozitave, GKK do të vazhdojë zhvillimin e programeve të edukimit dhe hulumtimit që synojnë afrimin e publikut me artin, përmes punëtorive, ligjëratave, diskutimeve dhe programeve të ndërmjetësimit.

Në kuadër të këtij programi, Galeria Kombëtare e Kosovës prezanton projektin *Punk, Fotografi, Video dhe Arkiva Vizuale në vitet 1980: Sllovenia dhe Kosova* nga Marina Gržinić dhe Elisa Maxhuni në bashkëpunim me Slavcho Dimitrov. Projekti do të hulumtojë politikën e vizuale në Jugosllavinë socialiste të vonë, duke analizuar se si imazhet, trupat dhe praktikat mediatike sfiduan ideologjinë shtetërore. Hulumtimi e sheh punk-un si një lëvizje solidariteti ndër-republikane në ish-Jugosllavi, të lidhur ngushtë me konfliktet politike, shtypjen shtetërore dhe mobilizimet qytetare të fund viteve 1980.

Në bashkëpunim me Institutin Sekhmet do të zhvillohet programi *Proceset Kuratoriale si Praktikë* e Kujdesit si hapësirë edukative dhe diskursive për zhvillimin e praktikave kuratoriale kritike në Kosovë. Programi përfshin një punëtori tre-ditore të udhëhequr nga kuratorët Shaunak Mahbubani, si dhe një ligjëratë publike nga artisti Astrit Ismaili. Me fokus në artin bashkëkohor



queer dhe përfaqësimin e grupeve të marginalizuara, projekti do të adresojë mungesën e edukimit formal kuratorial dhe nxit reflektimin mbi kurimin si proces etik, politik dhe shoqëror, duke promovuar kujdes, përfshirje dhe solidaritet brenda institucioneve kulturore.

Vita Kasapolli, Amalia Koleka dhe Shaha Hyseni, do të hulumtojnë arkivat për ta gjurmuar skulpturat e prodhuara pas vitit 2000, *Skulptura kosovare si praktikë bashkëkohore (2000–2025)*. Përmes analizave të materialeve arkivore dhe intervistave me artistë e kuratorë, projekti do të shqyrtoj zhvendosjen e skulpturës drejt instalacionit dhe formave të zgjeruara, marrëdhënien e saj me hapësirën publike dhe ndikimin në ndërgjegjen kolektive. *Shkolla e Vëmendjes* nga Likana Cana, projekt i bazuar në punëtori që trajton vëmendjen si medium artistik dhe “prompting”-un si praktikë krijuese. I frymëzuar nga tradita e Fluxus-it dhe konteksti bashkëkohor digjital, projekti synon të krijojë hapësira eksperimentale ku procesi i krijimit bëhet objekt studimi dhe reflektimi. Artistja Albina Fetahu do të sjellë *Mini Print Explorers*, punëtori për fëmijë që do t'i njoftojë ata me botën e grafikës përmes lojës dhe eksperimentimit. Me teknika të thjeshta dhe të sigurta, si stampimi me foam, stencil dhe shtresëzimi i ngjyrave, fëmijët eksplorojnë proceset e printimit duke zhvilluar shkathtësi praktike dhe kreativitet vizual.

Njëkohësisht, Galeria Kombëtare e Kosovës po punon lidhur me përfaqësimin e ardhshëm të vendit në Ekspozitën e 61-të Ndërkombëtare të Artit në La Biennale di Venezia ku Kosova do të prezantohet me ekpozitën *Dhëmbë të Fortë*, nga Brilliant Milazimi, kuruar nga José Esparza Chong Cuy.

Programi është përzgjedhur nga Këshilli Drejtues i GKK-së i kryesuar nga Renea Behluli, dhe i përbërë nga anëtarët Linda Gusia, Agron Blakçori, Somer Şpat, Guri Çavdarbasha dhe Bariu Zenelaj

Kontakti për komunikim:

Anila Spahiu, *Koordinatorë për Media dhe Marrëdhënie me Publikun*
info@galeriakombetare-rks.com

Adresa:

Galeria Kombëtare e Kosovës QAFA
Kompleksi QAFA, nr.15,
10000 Prishtinë, Kosovë
<https://www.galeriakombetare-rks.com/>

Orari i hapjes:

E martë – E premte: 10:00 – 18:00
E shtunë – E dielë: 10:00 – 17:00

Hyrja Falas